



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:077800
Datë: 12.04.2023
Numri i dokumentit: 04181341

Ac.nr.6175/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Naim Mehollli, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.R. nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati A. P. nga Prishtina, kundër të paditurës Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësorë i Kosovës me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson zyrtari i lart ligjor Besim Mustafa, për kompensim të dëmit material dhe jo material, duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit dhe të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.674/12 e datës 27.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 03/04/2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht ankesa e të paditurës Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.674/12 e datës 27.10.2020, në pikën I dhe II të dispozitivit dhe gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit për shkak të privimit të kundërligjshëm nga liria për 117 ditë, në emër të kompensimit të dëmit jo material për vuajtje shpirtërore, për cenim të autoritetit, të nderit, të lirisë, të drejtave të personalitetit dhe frikës së përjetuar, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 11,700.00 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, kurse pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e gjykuar prej 1,629,988.300 euro, REFUZOHET SI E PA BAZUAR.

II.APROVOHET pjesërisht ankesa e paditësit H. R. dhe ankesa e të paditurës Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësorë i Kosovës me seli në Prishtinë dhe PRISHET pika III, pika IV.5,6 dhe pika V e dispozitivit të aktgjykimit ankimore dhe çështja kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

II.Refuzohen pjesërisht ankesa e paditësit H. R. dhe ankesa e të paditurës Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.674/12 e datës 27.10.2020 në pikën I të dispozitivit sa i përket kamatës dhe në pikën IV.1,2,3,4 të dispozitivit, VERTETOHEN.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin ankimor C.nr.674/12 e datës 27.10.2020, ka vendosur si vijon:

- I. APROVOHET Pjesërisht si e bazuar Kërkesëpadia e Paditësit H.R. nga Prishtina sa i përket dëmit jo material dhe detyrohet e Paditura Republika e Kosovës – Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë që Paditësit H. R. t'ia paguaj shumën si në vijim:
1. Në emër të dhimbjeve shpirtërore – vuajtjeve psikike të intensitetit të lartë për shkak të privimit të pa bazë të lirisë dhe qëndrimit në paraburgim për 117 ditë, për secilën ditë nga 200 € (dyqind euro), gjithsej shumën 23.400.00 € (njëzetë e tre mijë e katër qind euro);
 2. Në emër të dhembjeve shpirtërore – vuajtjeve psikike të intensitetit të mesëm prej periudhës së ndërprerjes së paraburgimit e deri në pushimin e procedurës penale, nga data 23.11.2010 deri me datën 11.01.2011, gjithsej 49 ditë, për secilën ditë nga 100 € (njëqind euro), gjithsej shumën 4.900.00 € (katër mijë e nëntëqind euro);
 3. Për shkak të shkeljes së nderit, dëmtimit të integritetit dhe personalitetit, për shkak të rrënimit të prestigjit, dëmtimit të imazhit dhe reputacionit të Paditësit, nga data e arrestimit 23.07.2010 deri më datën e pushimit të procedurës 11.01.2011, gjithsej 172 ditë për secilën ditë nga 100 € (njëqind euro), gjithsej shumën 17.200.00 € (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind euro); apo në tërësi shumën totale për pikën I të dispozitivit 45.500.00 € (dyzet e pesë mijë e pesëqind euro), me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në banka pa destinim të caktuar, duke u përlllogaritur nga data e marrjes së aktgjykimit deri në pagesën definitive.
- II. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e dëmit jomaterial me kamatë ligjore përtej shumave të gjykuara si në pikën I të dispozitivit.
- III. APROVOHET në tërësi si e bazuar Kërkesëpadia e Paditësit H. R. për kompensimin e dëmit material, t'ia paguaj shumën si në vijim:
1. Për shkak të pushimit të tij nga puna në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) në datën 23.07.2010 e deri në skadencën e mandatit si guvernator, datë 26.03.2013, në emër të fitimit të humbur nga të ardhurat personale të pa realizuara dhe benifiteve tjera përcjellëse
 - i. Në emër të pagave neto të papranuara, shumën 109.834.00 € (njëqind e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër euro);
 - ii. Në emër të kontributit pensional të pa paguar, shumën 12.846.00 € (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë euro), shumë kjo e cila duhet të transferohet në trustin pensional të kursimeve në emër të Paditësit H.R.;
 - iii. Në emër të tatimit në pagë të papaguar, shumën 12.204.00 € (dymbëdhjetë mijë e dyqind e katër euro), shumë kjo e cila duhet të transferohet pranë Administratës Tatimore të Kosovës;
 - iv. Në emër të kursimeve në sigurimin Slloveno–Kosovar, kontributin në shumën 15.543.00 € (pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre euro).

2. Në emër të shpenzimeve të procedurës penale, shumën sipas faturës në lartësi 8.380.00 € (tetë mijë e treqind e tetëdhjetë euro); apo në tërësi shumën totale për pikën III të dispozitivit 158.807.00 € (Njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatë euro);

IV. REFUZOHET Kërkesëpadia e Paditësit për Kompensimin e dëmit material për përudhën prej skadimit të mandatit të Guvernatorit të BQK-së, datë 26.03.2013, deri me datën 30.11.2019 që t'i paguhen shumat si në vijim:

1. Diferenca neto në pagë në shumën prej 88.585.00 €,
2. Diferenca në emër të kontributit personal 17.588.00 €
3. Diferenca në tatimin në pagë në shumën prej 16.708.00 €,
4. Diferenca në emër të kursimeve në sigurimin e Slloveno–Kosovar, në emër të kontributit shumën prej 29.796.00 €,
5. Kompensimin për shpenzimet e vizitave nga familjarët, shumën prej 15.000.00 €,
6. Në emër të pakove shumën prej 5.000.00 €,

V. DETYROHET e paditura që shumat e gjykuara si në pikën I dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguaj paditësit, si dhe shpenzimet e procedurës, në shumën 3,382.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, në kërcenim të detyrimit me përmbarrim.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar pjesërisht aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e paditësit të miratohet si e bazuar ndërsa aktgjykimi ankimor të ndryshohet, ashtu që kërkesëpadia e paditësit të miratohet si e bazuar si në parashtrësën mbi precizimin e kërkesëpadisë të datës 06/10/2020.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet në tërësi, ashtu që aktgjykimi i atakuar të anulohet dhe lëndën ta kthej në rigjykim për vendosje meritore, apo të njëjtën ta ndryshoj dhe paditësit H.R. nga Prishtina, t'ua njeh të drejtën e kompensimit në emër të dëmit material dhe jo material, konform kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ 04/2015 (të KGJK-së), për zbatimin e procedurës së kompensimit të dëmit për personat e dënuar ose arrestuar pa bazë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit, me propozim që Gjykata e Apelit të refuzon ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesat e ndërgjyqësve janë pjesërisht të themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi H.R., përmes të autorizuarit të tij, me datën 27.03.2012, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, për dëmshpërblim, kundër të paditurës Republika e Kosovës-Këshilli Gjyqësorë i Kosovës me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që gjykata ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia paguaj dëmin jo material si vijon:

I. Në emër të dhimbjeve shpirtërore-vuajtje psikike shumë prej 200,000.00 euro, për cenim të shkeljes së nderit shumë prej 200,000.00 euro, për shkak të cenimit të lirisë shumë prej 350,000.00 euro, për shkak të privimit pa bazë të lirisë, për qëndrimin në paraburgim shumë prej 400,000.00 euro, për shkak të dëmtimit të integritetit të personalitetit shumë prej 150,000.00 euro, për shkak të rrënimit të prestigjit shumë prej 130,000.00 euro dhe për shkak të dëmtimit të imazhit dhe reputacionit shumë prej 200,000.00 euro, apo shuma totale për piken I të dispozitivit prej 1,630.000.00 euro, me kamat ligjore prej 8 % në vit nga data 27/03/2012.

II. Në emër të kompensimit të dëmit material: për periudhën prej pushimit të tij nga puna në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) datë 23.07.2010 e deri në skadimin e mandatit si guvernator, datë 26.03.2013, të paguaj diferencën neto në shumë prej 109,834.00 euro, për kontribut pensional diferencën prej 12.846.00 euro, për tatim në pagë të paguaj shumë prej 12.204.00 euro, për kursime në sigurimin Slloveno–Kosovar, të paguaj kontributin në shumë prej 15.543.00 euro, pastaj për periudhën prej skadimit të mandatit të guvernatorit data 26/03/2013 e deri me 30/11/2019, të paguaj diferencën neto në shumë prej 88,585.00 euro, për kontribut pensional, të paguaj diferencën prej 17.588.00 euro, për tatim në pagë, të paguaj shumë prej 16.708.00 euro, për kursime në sigurimin Slloveno–Kosovar, të paguaj kontributin në shumë prej 29,796.00 euro, për kompensim të shpenzimeve të vizitave nga familjaret, të paguaj shumë prej 15,000.00 euro, pastaj për pako, të paguaj shumë prej 5000 euro dhe për shpenzime të procedurës penale, të paguaj shumë sipas faturës në lartësi prej 8.380.00 € apo shumë e përgjithshme prej 323,104.00 euro si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 3,382.50 euro.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka qenë i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në pozitën e Guvernatorit të Përgjithshëm të BQK-së në Prishtinë me mandat 3 vjeçar dhe atë deri me datën 26.03.2013, mandej ka theksuar se kundër paditësit është zhvilluar procedurë penale dhe me datën 23/07/2010, i njëjti është arrestuar dhe ka qenë nën masën e paraburgimit deri me datën 23/11/2010, apo gjithsejtë 117 ditë, ndërsa me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë KA.nr.547/11 e datës 11/01/2012, është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës së Qarkut Ka.nr.547/2011 e datës 12/12/2011, me të cilin është hedhur poshtë akuza e ngritur kundër paditësit, pastaj e paditura në procedurë administrative me datën 08/03/2012, i ka ofruar shpërblim dëmi paditësit në emër të kompensimit të dëmit material (fitimit të humbur), në shumë prej 14.881.03 euro, në emër të dëmit jomaterial (moral) shumë prej 702.00 euro, në emër të përpilimit të kërkesës për kompensim dhe përfaqësim nga ana e avokatit në përputhje me listën e Odës së Avokatëve në shumë prej 120 euro, në emër të shpenzimeve për vizita familjareve dhe pakove shumen prej 200 euro apo shumë e përgjithshme për të gjitha kategoritë e dëmit, në shumë prej 15.903.03 euro e të cilën ofertë paditësi nuk e ka pranuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë po ashtu theksohet se nga titujt e gazetave vendore dhe atyre ndërkombëtare lidhur me arrestimin e paditësit, vërtetohet se i njëjti gjatë kësaj periudhe kishte qenë objekti i vazhdueshëm i shkrimeve të mediave në Republikën e Kosovës edhe atyre ndërkombëtare dhe këto shkrime kishin qenë me ndikim në rrënimin e reputacionit dhe autoritetit të tij, duke pasur parasysh se i njëjti ka qenë me një funksion të lartë në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe këto shkrime kanë ndikuar në shkaktimin e dëmit moral të cilin e përcakton edhe ekspertiza e psikiatrisë duke konstatuar se gjatë periudhës së

paraburgimit prej 4 muajve ka përjetuar vuajtje dhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë, dhimbje shpirtërore dhe vuajtje të intensiteti të mesëm, që kanë vazhduar deri me lirimin nga aktakuza me datën 11.01.2012 dhe pas liritimit ka manifestuar dhembje dhe vuajtje shpirtërore të intensitetit të ulët në vazhdimësi e që janë prezent edhe sot e kësaj dite dhe mbi bazën e këtyre parametrave si faturës dhe ekspertizës financiare e ka vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë aprovuese, ndërsa pjesën tjetër të kërkesëpadisë e ka refuzuar në mungesë të provave materiale. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 354.1 të KPPK-së, nenin 200 al.1.1, nenin 155, nenin 277 të LMD-së, nenin 4, 5, 7, 8, 10, 143 dhe nenin 146 të LPK-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar, ndërsa pjesa e prishur e aktgjykimit është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182 par.2 pika n) e LPK-së.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për arsye se baza juridike e kërkesëpadisë nuk ishte kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse, se paditësi është privuar nga liria pa bazë për 117 ditë, dhe kjo është provuar me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë KA.nr.547/11 e datës 11/01/2012, me të cilën është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës së Qarkut Ka.nr.547/2011 e datës 12/12/2011, ku është hedhur poshtë akuza e ngritur kundër paditësit, për shkak të dyshimit se i njëjti ka kryer veprat penale për të cilat ju vihen në barrë, këtë gjendje faktike e ka pohuar edhe e paditura me rastin e ofrimit të kompensimit të dëmit në procedurë administrative si dhe gjatë seancave të shqyrtimit kryesor. Sipas nenit 321.2 të LPK-së parashihet: *Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor.* Gjykata e Apelit nuk e pranon qëndrimin dhe përfundimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, sa i përket lartësisë së dëmshpërblimit të cilin në këtë rast ia ka gjykuar paditësit si në piken I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, dhe vlerëson se pavarësisht gjendjes së vërtetuar faktike dhe mospërfshirjes së aktgjykimit të atakuar me shkelje esenciale të procedurës në këtë pjesë të aktgjykimit, gjykata sa i përket lartësisë së kompensimit për paditësin, ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, kur paditësit ia ka caktuar shumë më të shpërblimit të dëmit jo material në lartësi prej 45,000 euro e cila shumë nuk është në harmoni me praktiken e deritanishme gjyqësore. Sipas udhëzuesit për caktimin e kritereve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejt në të holla të dëmit jo material të lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës Gj.A.nr.41/2023 e datës 27/02/2023, është paraparë shuma për një ditë të heqjes së lirisë prej 30 euro deri 60 euro.

Gjykata e Apelit gjatë vendimmarrjes me rastin e ndryshimit të aktgjykimit e ka pasur parasysh udhëzuesin për caktimin e kritereve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejt në të holla të dëmit jo material të lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, por duke marr parasysh mënyrën dhe rrethanat e heqjes së lirisë së paditësit, të njëjtit i caktoj shumë më të shpërblimit të dëmit mbi këto kritere të përcaktuar dhe atë për një ditë të heqjes së lirisë ia caktoj kompensimin e dëmit në lartësi prej 100.00 euro, duke pasur parasysh moshën e paditësit, personalitetin e tij dhe profesionin, pasi që paditësi në kohën e arrestimit ka qenë i moshës 52 vjeçar dhe ka mbajtur pozitën e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, që nënkupton se paditësit ju ka besuar një ndër pozitave më të larta shtetërore për menaxhimin e këtij institucioni të pavarur dhe rrjedhimisht paditësi në këtë moshë ka pasur mundësi potenciale, që në të ardhmen të

avancohet në karrierën e tij profesionale, mandej si parametër për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit, Gjykata e Apelit e ka marr parasysh edhe jehonën mediatike që i është dhënë rastit me rastin e arrestimit të paditësit dhe gjatë kohës së heqjes së lirisë, ngase në shkresat e lëndës rezulton se paditësi është arrestuar në vendin e tij të punës dhe është prangosur, ku i gjithë ky proces është përcjell nga mediat, ashtu që në shkresat e lëndës gjenden artikuj të ndryshëm të mediave si vendor ashtu edhe atyre ndërkombëtare, ku e informojnë opinionin publik lidhur me arrestimin e paditësit dhe atë për veprat penale për të cilat dyshohej se i ka kryer gjatë ushtrimit të pozitës së Guvernatorit si: Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, Ushtrim ndikimit, Pastrim parave, Shmangie Tatimi dhe Marrje ryshfeti, e të cilat vepra nuk është provuar se paditësi i ka kryer dhe për këto arsye është hedhur poshtë aktakuza në procedurën e konfirmimit të aktakuzës nga ana e gjykatës penale.

Gjykata e Apelit me rastin e caktimit të lartësisë së kërkesëpadisë së paditësit, gjithashtu ka marr parasysh edhe kohëzgjatjen e qëndrimit të tij në paraburgim prej 117 ditë, ku gjatë kësaj kohe i njëjti ka përjetuar vuajtje dhe dhimbje shpirtërore që është manifestuar me vështirësi të adaptimit me kushtet penale dhe të ballafaqimit me procedurat gjyqësore, ndjenjën e frikës, ankthit, stresit për shkak të pasigurisë se çka e pret e ardhmja, ndjenjën e thellë të dëmtimit të imazhit dhe dinjitetit personal, moral, profesional dhe prestigjit si figurë autoritative, të gjitha këto kanë qenë prezentë gjatë periudhës së kufizimit të lirisë, ashtu siç ka konstatuar ekspertiza e psikiatrisë edhe pse kjo provë nuk ka pasur nevojë të nxirret, për shkak se vuajtjet e paditësit janë evidente, prandaj privimi i tij nga lira, faktikisht e ka dëmtuar rëndë paditësin në integritet dhe në përgjithësi në karrierën e tij profesionale, andaj nga këto arsye të lartcekur e ka caktuar shpërblimin e dëmit jo material për dhimbje shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit në shumë të përgjithshme prej 11,700.00 euro, e cila shumë llogaritet se do të përfaqëson një satisfaksion adekuat që i dëmtuari (në këtë rast paditësi) t'i përballojë më lehtë dëmet jo materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para, ku edhe praktika e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut me seli në Strasburg, ka përcaktuar se caktimi i kompensimit për këto kategori duhet të trajtohet si satisfaksion i të dëmtuarve dhe në asnjë mënyrë pasurim i tyre. Me nenin 183 par.2 të LMD përcaktohet se *“me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të, të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se, kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e dhembjeve shpirtërore të pësuar, ashtu që kompensimi të përfaqësoj një lehtësim në përbalimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësi i ka pësuar si pasojë e privimit të kundërligjshëm të lirisë nga ana e institucioneve gjyqësore të Republikës së Kosovës, në të njëjtën kohë ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjen mbështetje në nenin 136 dhe 183 të LMD-së, por edhe në nenin 5 par.5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, i cili shprehimisht përcakton se *“Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim”*. Të njëjtën të drejtë për kompensim këtu paditësit ia njeh edhe Protokollin 7 i Konventës së cekur më lartë, përkatësisht neni 3 i saj, i cili shprehimisht thotë: *“Kur një person është dënuar për një veprë penale me vendim të formës së prerë dhe kur ky dënim është anuluar më vonë, ose në rast faljeje, për shkak të një fakti të ri ose të zbuluar rishtazi që provon një gabim gjyqësor, personi që ka pësuar ndëshkimin për arsye të këtij dënimi, zhdëmtohet sipas ligjit ose praktikës në fuqi në Shtetin në fjalë...”*

Sipas Gjykatës së Apelit vlerësohet se, nga gjykata e shkallës së parë është vendosur drejtë edhe lidhur me kamatën e gjykuar respektivisht për lartësinë e saj, dhe atë konform nenit 277 të LMD-së, e cila pavarësisht se kur ka lindur marrëdhënia e detyrimeve, për kërkesat që i referohen dëmit jo material, kamata fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së aktgjykimit në gjykatën e shkallës së parë, e deri në pagesën definitive, po ashtu gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur si në piken IV.1,2,3,4 të dispozitivit të aktgjykimit, për shkak se nuk është vërtetuar baza juridike e kësaj pjese të kërkesëpadisë, pasi që rizgjedhja në mandatin e Guvernatorit të BQK-së për periudhën 26.03.2013 e deri më datën 13.11.2019 ka qenë një rrethanë e ardhshme e pasigurt, sepse për tu vazhduar mandati edhe për periudhën e lartcekur paditësi ishte dashur që ti nënshtrohet një procesi konkurrues përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Gjykata e Apelit vendosi si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për arsye se pika III, pika IV.5,6 dhe pika V e dispozitivit të aktgjykimit ankimore është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182 par.2 pika n) të LPK-së, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me arsyet e aktgjykimit si dhe nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare, ngase gjykata e shkallës së parë gjatë vendimmarrjes e ka marr si të mirëqenë ekspertizën financiare e cila ka konstatuar se për periudhën nga data 23/07/2010 e deri me 26/03/2013, paditësi i takon kompensimi i pagës në shumë prej 108,979.00 euro, ndërsa gjykata e shkallës së parë këtë formë të dëmit të pretenduar, paditësi ia gjykon në shumë prej 109,834.00 euro, pastaj ekspertiza financiare ka konstatuar se kontributi pensional i pa paguar është në shumë prej 12,746.00 euro, ndërsa gjykata e shkallës së parë këtë formë të dëmit të pretenduar, paditësi ia gjykon në shumë prej 12,846.00 euro, mandej ekspertiza financiare ka konstatuar se tatimi në pagë i pa paguar është në shumë prej 12,109.00 euro, ndërsa gjykata e shkallës së parë këtë formë të dëmit të pretenduar, paditësi ia gjykon në shumë prej 12,204.00 euro, prandaj pika III e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar është në kundërtënie me ekspertizën financiare dhe gjykata nuk jep arsye se në cilat prova është bazuar, kur ka ardhur deri në këtë përfundim, pastaj aktgjykimit të atakuar i mungojnë arsyet edhe për faktet vendimtare, sa i përket vendimit për kompensimin e pagës pas periudhës së heqjes së masës së paraburgimit e deri në skadimin e mandatit, kur kihet parasysh se paditësi nuk ka pasur ndonjë ndalesë që të ushtroj serish detyrat e punës së Guvernatorit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, ndërsa pretendimi i paditësit se të njëjtit ju ka ndërprerë mandati, kjo është çështje që duhet të shqyrtohet në procedurë tjetër gjyqësore-kontest pune me punëdhënësin se i njëjti a ka vepruar sipas ligjit apo jo me rastin e ndërprerjes së mandatit dhe në këtë drejtim duhet të shqyrtohet legjitimiteti pasiv i palës së paditur, mandej e paditura gjatë shqyrtimit kryesor e ka njoftuar gjykatën e shkallës së parë se paditësi është duke zhvilluar kontest pune me punëdhënësin lidhur me kompensimin e pagave e të cilin pretendim gjykata fare nuk e ka shqyrtuar, po ashtu dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor edhe me arsyetimin e aktgjykimit, ku në faqen 11 të arsyetimit, gjykata e instancës me të ulët e konstaton faktin e pa kontestuar se paditësi ka pësuar dëm në emër të shpenzimeve të vizitave familjare dhe pakove dhe e paditura për këtë formë të dëmit në procedurën administrative i ka paraqitur ofertë për kompensimin e dëmit, ndërsa në anën tjetër gjykata e shkallës së parë këtë formë të dëmit pa dhënë arsye ia refuzon paditësit, mandej gjykata e shkallës së parë ia njuh paditësit edhe shpenzimet e procedurës penale sipas faturës në lartësi prej 8,380.00 euro, por në shkresat e lëndës nuk ka provë materiale se paditësi këto shpenzime i ka paguar, respektivisht nuk janë prezantuar dëshmitë e specifikuar në faturë, për ti vlerësuar se këto shpenzime të pretenduara a kanë qenë të domosdoshme dhe a janë në harmoni me tarifën e Odes së Avokateve apo jo. Andaj, shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë si në piken III dhe IV.5,6 të dispozitivit të aktgjykimit ankimore, që domosdo është dashur të priset.

Gjykata e Apelit vendosi që të prish edhe piken V të aktgjykimit ankimor duke u bazuar në nenin 465.3 të LPK-së e cila dispozitë parasheh: Kur anulohet vendimi, kundër të cilit është paraqitur mjeti i goditjes dhe lënda kthehet për rigjykim, do të lihet që për shpenzimet lidhur me procedurën sipas mjetit të goditjes të vendoset me vendimin përfundimtar.

Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që të bëjë eliminimin e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore në pajtim me vërejtjet e paraqitura, ashtu që të shqyrton pretendimin e të paditurës se paditësi a ka iniciuar kontest pune me punëdhënësin përkitazi me kompensimin e pagave dhe për cilën periudhë kohore, nëse vërtetohet fakti se paditësi zhvillon kontest pune me punëdhënësin për kompensimin e pagave nga momenti i arrestimit e deri në skadimin e mandatit, atëherë të ftohet paditësi që të deklarohej se nga cila palë kërkon kompensimin e dëmit sepse paditësi nuk mundet të kërkojë dëmin e njëjtë edhe nga e paditura edhe nga punëdhënësi, nëse nuk vërtetohet ky fakt atëherë të ftohet eksperti financiar që të plotësojë mendimin dhe konstatimin e tij, në atë mënyrë që të precizoj fitimin e humbur nga të ardhurat personale për periudhën kohore nga momenti i arrestimit e deri në heqjen e masës së paraburgimit apo për 117 ditë, si dhe të precizoj ekspertizën nga momenti i heqjes së masës së paraburgimit e deri në momentin e skadimit të mandatit, mandej eksperti financiar të verifikoj se fatura për shpenzimet e procedurës penale a është evidentuar në librat kontabël dhe a është raportuar në Administratën Tatimore të Kosovës, nëse vërtetohet ky fakt relevant atëherë gjykata e shkallës së parë, këtë formë të dëmit duhet të vlerësojë mbi bazën e dëshmimeve që vërtetojnë se shpenzimet e pretenduara a kanë qenë të domosdoshme për vërtetimin e drejt dhe të plotë të gjendjes faktike dhe të vlerësohen sipas tarifës së Odes së Avokateve të Kosovës, mandej të vërteton lartësinë e formës së kompensimit të dëmit për pako dhe shpenzimet e vizitave nga familjarët, duke pasur parasysh numrin e vizitave të realizuara, pastaj shpenzimet e krijuara të familjarëve gjatë vizitave si dhe të vërteton lartësinë e pakove që i ka pranuar paditësi deri sa ka qenë nën masën e paraburgimit, duke pasur parasysh nenin 66 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale si dhe në rast nevojë të kërkon nga institucioni korrektues, ku paditësi ka qenë në paraburgim informata për numrin e vizitave, dhe përmbajtjen e pakove që i ka pranuar paditësi siç e parasheh rendi shtëpiak i institucionit korrektues dhe pastaj eksperti financiar të jep mendim edhe përkitazi me këtë formë të dëmit e po ashtu të vlerëson të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, me qëllim që të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika c), d) dhe e) e lidhur me nenin 201 pika d) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.6175/20, me datë 03.04.2023

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku